



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 mars 2012  
Nr. ref.: RK204/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin Nr. KI 37/11

Parashtruesi

**Jalldyze Kastrati**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev.nr.5/2008, të 9 korrikut 2010**

### GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Jalldyze Kastrati, nga Gjakova, me banim në rr. Nëna Terezë banesa nr. 7, e përfaqësuar nga avokati, z. Hasan Shala, nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.5/2008, i datës 09. 07. 2010, me anë të cilit është refuzuar Revizioni i të paditurës, znj. Jalldyze Kastrati, nga Gjakova, i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 318/2004, i datës 08.05.2007, të cilin pala e ka pranuar më 17 shtator 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 16 mars 2011, është kontesti i punës që parashtruesja e kësaj kërkesë e ka me ish-punëdhënësin e saj, SH.A "Virgjinia" nga Gjakova, e që ka të bëjë me mospagesën e të ardhurave personale për periudhën kohore 14.11.1994 deri me 28.08.1997, sa ka qenë në mënyrë të kundërligjshme e larguar nga puna. Parashtruesja e kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore për këtë rast dhe duke qenë e pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, ajo ka ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme, dhe pikërisht Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.5/2008, i 09 korrikut 2010, është akti i autoritetit publik të cilin e konteston parashtruesja, ndaj të cilit kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë.

## **Baza Juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 16 mars 2011, znj. Jalldyze Kastrati parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me të cilën kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 5/2008, të 9 korrikut 2010.
6. Më 23 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës që kësaj Gjykate t'ia paraqesë të gjithë dokumentacionin për ecurinë e lëndës, në të gjitha instancat gjyqësore, duke përfshirë edhe vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.
7. Më 4 prill 2011, Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga përfaqësuesi ligjor i parashtrueses së kërkesës plotësimin e kërkesës me dokumentacionin e kërkuar.
8. Më 18 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu anëtar dhe Gjyljeta Mushkolaj, anëtare.
9. Më 14 qershor 2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Gjyljeta Mushkolaj (anëtare), i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

10. Znj. Jalldyze Kastrati ishte në marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar në KBI "Virxhinia" SH.A. në Gjakovë.

11. Më 15 nëntor 1994, Komisioni disiplinor i punëdhënësit, KBI SH.A "Virxhinia", në Gjakovë, me Vendim nr. 105 ia ka shqiptuar znj. Kastrati masën disiplinore "ndërprerje të marrëdhënies së punës", ndërsa Komisioni i ankesave i të njëjtit punëdhënësi me vendim nr. 138, të 23 dhjetorit 1994, ka vërtetuar vendimin e Komisionit disiplinor lidhur me shqiptimin e kësaj mase disiplinore.
12. Më 24 dhjetor 1996, Gjykata Komunale në Gjakovë me Aktgjykimin P. nr. 9/95 ka aprovuar kërkesë-padinë e znj. Kastrati dhe ka anuluar vendimet e punëdhënësit, KBI SH.A "Virxhinia", dhe ka obliguar të paditurën që ta kthejë në punë znj. Kastrati me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.
13. Më 23 janar 1998, me Aktgjykimin P. nr. 60B/96, Gjykata Komunale në Gjakovë ka aprovuar kërkesë-padinë tjetër të paditëses, znj. Kastrati, dhe ka obliguar KBI Sh.A. "Virxhinia" që t'ia kompensojë të ardhurat personale të pa paguara në emër të largimit të paligjshëm nga puna për periudhën kohore 14 nëntor 1994 deri më 28 gusht 1997, në shumën prej 13.332.00 dinarëve të atëhershëm, së bashku me kamatën ligjore të llogaritur nga 1 janari 1997.
14. Më 27 nëntor 1998, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës Sh.A. "Virxhinia" në Gjakovë, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktvendimin Ac. nr. 673/98 e kishte prishë aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Gjakovës C. nr. 608/96, të 23 janarit 1998 dhe lënda i është kthyer Gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje, me vërejtjen nëse ka qenë i plotfuqishëm Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë C. nr. 9/1995. Kjo lëndë ka ngelë e papërfunduar para luftës në Kosovë, ashtu që paditësja me parashtresën e 12 shkurtit 2002, ka kërkuar vazhdimin e procedurës.
15. Më 25 mars 2004, me Aktgjykimin e saj C. nr. 84/02, Gjykata Komunale në Gjakovë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe e ka aprovuar kërkesë-padinë e paditëses për kompensimin e pagave mujore të papaguara në shumën prej 2.238,00 € si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 700,00 €.
16. Më 8 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin A. C nr. 318/04, ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 84/02, të 25 marsit 2004, dhe ka hedhur poshtë si të pabazuar kërkesë-padinë e paditëses, znj. Jalldyze Kastrati, për kompensimin e pagave të pa paguara duke theksuar se SH.A. "Virxhinia" e tanishme nuk është pasardhëse e ish-KBI SH.A "Virxhinia" dhe paditësja nuk është në "raport juridik-civil a të punës" me punëdhënësin e tashëm SH.A. "Virxhinia", prandaj ky punëdhënësi nuk ka asnjë obligim ndaj paditëses.
17. Më 09 korrik 2010, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 5/2008, ka hedhur poshtë si të pabazuar Revizionin e paraqitur nga paditësja, znj. Jalldyze Kastrati, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 318/2004, të 8 majit 2007.
18. Sipas deklarimit personal të shkruar në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, znj. Jalldyze Kastrati, ka pohuar se Aktgjykimin e Gjykatës Supreme e ka marrë më 17 shtator 2010.
19. Më 16 mars 2011, znj. Jalldyze Kastrati, përmes përfaqësuesit të saj, avokatit z. Hasan Shala, parashtronjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cekura në kërkesë.

### **Pretendimet e parashtrueses së kërkesës**

20. Parashtruesja e kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë të parapara me nenet 23 (Dinjiteti Njerëzor), 24

(Barazia para Ligjit), 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit).

21. Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, ka theksuar se Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar REVIZIONIN e paditëses me Aktgjykimin i Rev. nr. 5/2008, të 9 korrikut 2010, ia ka pamundësuar realizimin e të drejtës së saj për kompensimin e pagave të papaguara për kohën që ajo në mënyrë të kundërligjshme ishte e larguar nga puna, prandaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese që t'ia njohë këtë të drejtë.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

22. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë në tërësi kërkesën e parashtrueses, duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Gjykata, gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe në të cilin përcaktohet;

*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.*

24. Në Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në rregullin 36, paragrafi 1, është thënë qartazi se: Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

*"b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi".*

25. Duke shqyrtuar faktet relevante të paraqitura në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesja nuk e ka përmbushur kushtin e pranueshmërisë së kërkesës, për shkak se nuk e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, të kërkuar me dispozitat juridike të cekura në paragrafët paraprakë të këtij raporti, sepse Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 5/2008 e kishte pranuar më 17 shtator 2010, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e kishte dorëzuar më 16 mars 2011, pra pas kalimit të fatit prej 4 (katër) muajsh brenda të cilit e kishte obligim ligjor ta paraqiste atë.

26. Në rastin konkret, Gjykata thekson se kriteri juridik i pajtueshmërisë me afatin 4 mujor për paraqitjen e një kërkesë ka për qëllim që të promovojë parimin e sigurisë juridike dhe të sigurojë palët se lëndët që janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese ekzaminohen brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mbrojnë autoritetet dhe palët e tjera të interesuara nga situatat e të qenkëshit në "paqartësi" për një periudhë të gjatë kohore (shih (ECHR *P.M. v. the United Kingdom* Aplikacioni nr. 6638/03, i datës 24 gusht 2004 )

27. Prandaj, nga rrethana e cekur më lartë, del se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë për shkak të paraqitjes së kërkesës pas kalimit të afatit 4 (katër) mujor, siç është paraparë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, dhe:

### PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1(b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 14 qershorit 2011, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- I. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani